



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TË
ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
DREJTORIA E POLITIKAVE DHE STRATEGJIVE TË ZHVILLIMIT TË ARSIMIT,
SPORTIT DHE RINISË

Nr. 511 Prot.

Tiranë, më 18.01. 2019

Lënda: Për kualifikimet e mësuesve për vitin shkollor 2018 - 2019

DREJTORISË ARSIMORE RAJONALE _____

ZYRËS ARSIMORE _____

INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE
KUALIFIKIMEVE

Në mbështetje të Ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr.2, datë 12.02.2015, “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije se:

1. Provimi me shkrim për kategoritë e kualifikimit të mësuesve, në sistemin arsimor parauniversitar për vitin shkollor 2018 – 2019, do të zhvillohet më datën 06.04.2019 ora 10.00-12.30 në Tiranë, në mjedise të planifikuara nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit.
2. Të gjithë kandidatët të njihen me programet e kualifikimit nga DAR/ZA-të, brenda datës 21 Janar 2019.
3. Mësuesit kandidatë për provimet e kualifikimit, plotësojnë formularët e aplikimit për të marrë pjesë në procedurat e kualifikimit dhe dorëzojnë portofolët e tyre sipas profileve përkatëse, brenda datës 4 Shkurt 2019.

4. Listat e kandidatëve për provimet e kualifikimit, së bashku me vlerësimet e portofolit, i përgatit DAR/ZA (sipas formatit të IZHA-s) brenda datës 12 Shkurt 2019.
5. Lista e kandidatëve për provimet e kualifikimit ju bëhet e ditur mësuesve gjatë periudhës 12-14 Shkurt 2019, në mënyrë që mësuesit kandidatë të kontrollojnë të dhënat dhe vlerësimet e portofolëve të tyre.
6. DAR-i harton listat përfundimtare (duke përfshirë edhe ZA-të përkatëse) sipas formatit të IZHA-s për hedhjen e të dhënave dhe i dërgon në formë elektronike dhe zyrtare në IZHA brenda datës 25 Shkurt 2019. Pas kësaj date nuk mund të bëhen ndryshime në listën e mësuesve kandidatë.

Duke ju falënderuar,

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Oltjon Muzaka

